REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Nr. 2893 Prot., Vlorë 21.10.2026

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË

Nr. 2511 Prot., Tiranë 20.10.2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

DHE

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik"përfaqësuar nga **Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit** sipërfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Universiteti i Mjekësisë,Tiranë, **përfaqësuar nga Prof. Dr. Xheladin Draçini,në cilësinë e Rektorit.**

Me qëllim për interesa të përbashkëta, duke vlerësuar dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin e përbashkët ndërinstitucional, palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi(më poshtë **"Marrëveshja**

Bien dakord
Për të nënshkruar një Marrëveshje Standard të bashkëpunimit të bazuar në klauzolat në vijim:

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Universitetet përcaktojnë dhe rregullojnë me këtë marrëveshie hapësirat dhe cështjet e bashkëpunimit të ndërsjelltë, si dhe format dhe mënyrat e zbatimit të saj.

Neni 2
Baza ligjore

Bashkëpunimi do të ndërmerret duke pasur si subjekt disponueshmërinë e fondeve dhe miratimin e Universiteteve përmes aktiviteteve të tilla ose programeve të cilat kanë të bëjnë me:
1. Shkëmbimin e kërkimeve, mësimdhënies dhe personelit administrativ.
2. Shkëmbimin e studentëve të të gjitha niveleve.
3. Aktivitete të përbashkëta kërkimore.
4. Pjesëmarrje në seminare dhe takime akademike.
5. Programe të veçanta afatshkurtra akademike.
6. Programe të zhvillimit profesional.
7. Fusha të tjera në të cilat interesi i përbashkët konkret në bashkëpunim ka lindur ndërkohë ose do të zhvillohet.

Neni 3
Mënyra e Bashkëpunimit

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, anëtarët e Universiteteve do të përcaktojnë tipin, qëllimin dhe parimet e realizimit të kësaj marrëveshjeje në një aneks të veçantë të saj.

Neni 4
Detyrimet e palëve

Secili Universitet do të caktojë një person ndërlidhës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

Neni 5
Financimi dhe Burimet

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje varet nga disponueshmëria e fondeve për aktivitetet e përbashkëta. Të gjitha angazhimet, detyrimet dhe shpenzimet në lidhje me projektet e aprovuara nën këtë
marrëveshje do të administrohen në përputhje me çdo praktikë dhe politikë normale si dhe në përputhje me termat dhe kushtet e agjencive të fondeve për çdo universitet.

Neni 6
Respektimi i marrëveshjes

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje Universitetet nuk nënkuptojnë asnjë detyrim financiar..

Neni 7
Mirëbesimi

Amendamente të mundshme ose shtesa të kësaj marrëveshjeje do të formulohen dhe parashtrohen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.

Neni 8
Afati i marrëveshjes

Universitetet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjesh të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive Madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse Universitetet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.

Neni 9
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1.Kjo marrëveshje qëndron në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit.

2.Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.

3.Kjo marrëveshje mund të zgjidhet nëse secili prej Universiteteve paraqet 6 (gjashtë) muaj përpara një kërkesë me shkrim drejtuar Universitetit partner.

PËR

UNIVERSITETIN

"ISMAIL QEMALI" VLORË

REKTOR
PROF. DR. AURELA SALIAJ

PËR

UNIVERSITETI I MJEKËSISË,

TIRANË

REKTOR
PROF. DR. XHELADIN DRACINI